



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 16-32463/16
Kaçanik, 28. 10. 2016

Në bazë të nenit 5 (b), 12 (d) dhe 14. I lidhur me nenin 17 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, 01Nr. 3588/2008 të datës 25.09.2008, të Pikës 9.10 të Planit të Parcelimit dhe Riparcelimit, të Planit Rregullues Urban, “Zona e I-r” në Kaçanik, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 28 Tetor 2016, mori këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PROPOZIM VENDIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS 01Nr. 16-32463/16- PËR NDRYSHIMIN E PLANIT TË PARCELIMIT DHE RIPARCELIMIT PËR BLOKUN BL-A8, SIPAS PLANIT RREGULLUES TË ZONËS I DHE NJË PJESE TË ZONËS II

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës 01Nr. 16-32463/16 prej datës 23.09.2016- Për ndryshimin e Planit të Parcelimit dhe Riparcelimit në Bllokun BL-A8 (Parcela e krijuar me Planin Rregullativ mban numrin 194 dhe 195) sipas Planit Rregullues për Zonën e I (Parë) dhe një Pjese të Zonës II (Dytë).
2. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.



Arsyetim

Kryetari i Komunës Kaçanik, në bazë të Kërkesës së Afrim Bajrami 01Nr. 350-17309/16, na është drejtuar me Propozim Vendim 01Nr. 16-32463/2016 prej datës 23.09.2016- Për Ndryshimin e Planit të Parcelimit dhe Riparcelimit në Bllokun BL-A8(Parcela e Krijuar me Planin Rregullativ mban numrin 194 dhe 195) sipas Planit Rregullativ për Zonën e I (Parë) dhe një Pjesë të Zonës II (Dytë).

Plani i Parcelimit dhe Riparcelimit është i përfshirë në Pikën 9.10 të Planit Rregullues Urban “Zona I-r në Kaçanik.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28 Tetor 2016, shqyrtoj Propozimin Vendimin me numër të sipërshënuar, dhe duke u nisur nga fakti se Pika 9.10 e Planit të Parcelimit dhe Riparcelimit ka lënë mundësinë për ndërhyrje në bazë të Kërkesave, Arsyetimit të Drejtorisë si dhe Vlerësimit të Komisionit Profesional 06Nr. 350-33000/2016, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkiva.




Kryesuesi i Kuvendit
Xhejrol Gashi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01-Nr. 16-32463 2016
Kaçanik, 23.09. 2016

Në bazë të nenit 5.f, dhe nenit 17.b, të Ligjit 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 15 pika 16.1 të Rregullores për punë të Kuvendit, si dhe Planit Rregullativ për Zonën e Parë dhe një Pjesë të Zonës së Dytë, Kryetari i Komunës bën këtë:

**PROPOZIM VENDIM PËR NDRYSHIMIN E PLANIT TË PARCELIMIT DHE
RIPARCELIMIT PËR BLOKUN BL-A8, SIPAS PLANIT RREGULLATIV TË ZONËS
SË PARË DHE NJË PJESE TË ZONËS SË DYTË**

I.

Me këtë Propozim-Vendim bëhet ndryshimi I planit të parcelimit dhe riparcelimit në bllokun BL-A8 (parcela e krijuar me planin rregullativ mban numrin 194 dhe 195), sipas Planit Rregullativ për Zonën e Parë dhe një Pjesë të Zonës së Dytë.

II.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset : Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Kaçanikut.

III.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryetari
z. Besim Ilazi

Arsyetim

Këtë propozim vendim Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e bën duke u mbështetur në Planin Rregullativ për Zonën e Parë dhe një pjesë të Zonës së Dytë respektivisht në kapitullin 9.10 për Planin e Parcelimit dhe Riparcelimit dhe kërkuesën e bërë nga z. Afrim Bajrami.

Drejtori
Ukshin Qallaku